



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u> Nr. I faq. Prokurorica	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1241/15</u> Prot No. Data Datum <u>29.04.2015</u> Prishtine



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.04.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-508/15, për z. Sami Hamiti – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02- 508/15, për zyrtarin e lartë, z. Sami Hamiti – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji PKI).

z. Hamiti është hetuar për konflikt interesi sepse ka marrë pjesë në procedurat e vendimmarrjes në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës të datës 14 Janar 2015 dhe seancën e rregullt të datës 05 Shkurt 2015, në të cilat është diskutuar lidhur me shkarkimin dhe emërimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike të Komunës së Prishtinës.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), i ka dërguar z. Hamiti shkresën zyrtare përmes së cilës e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës kemi organizuar takim në zyrat e AKK-së në të cilin është njoftuar me pretendimet e palës denoncuese në lidhje me situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Nga Ekstrakti i Procesverbalit të Mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe në takim me z. Hamiti, kemi vërtetuar se së pari janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve ndërsa, më pas është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale të Prishtinës.

Nuk qëndron pretendimi i denoncuesit të rastit se veprimi i z. Hamiti paraqet konflikt interesi sepse gruaja e tij – Valbona Hamiti, në kohën e diskutimit në Kuvendit Komunal, ka qenë e punësuar në Ndërmarrjen Publike Banesore në funksionin “Zyrtare Kryesore Financiare”.

Kjo për faktin se Valbona Hamiti, që nga data 01.08.2014, nuk ushtron ndonjë funksion në Ndërmarrjen Publike Banesore. Kjo vërtetohet nga përgjigja zyrtare që Agjencia ka marrë nga zyrtarët e kësaj ndërmarrje.

Nuk qëndron as pretendimi tjetër i denoncuesit të rastit se veprimi i z. Hamiti paraqet konflikt interesi për shkak se vëllai i gruas së tij është anëtar i bordit të Ndërmarrjes Lokale “Stacioni i Autobusëve”. Kjo për arsye se ky fakt nuk ia ndalon z. Hamiti votimin për Komisionin e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

